



INDEKSI I TRANSPARENCËS PËR QEVERISJEN KOMUNALE 2021

PËR 38 KOMUNAT E KOSOVËS

MAJ 2022





Instituti Demokratik i Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse
dhe luftës kundër korrupsion përmes
promovimit të transparencës,
llogaridhënies dhe integritetit në të
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë



TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA © 2022. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të rezervuara të gjitha të drejtat për këtë raport dhe asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të jetë objekt i riprodhimit ose bartjes në asnjë formë mekanike ose elektronike, duke përfshirë fotokopjimin ose ndonjë sistem të ruajtjes ose tërheqjes së materialeve pa autorizimin paraprak të botuesit me shkrim. Publikimi mund të riprodhohet ose të bartet vetëm për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që ka për qëllim të përdorë fragmente ose materiale të ndryshme të këtij publikimi, është i detyruar ta tregojë qartë burimin sa herë që janë nxjerrë fragmentet ose materialet e përdorura.

Nëse keni ndonjë koment, kritikë ose sugjerim, ju lutemi na kontaktoni përmes ndonjë prej opsioneve të mëposhtme:

Adresa: Rruga Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10000, Prishtinë, Kosovë
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Nga: Diana Metushi Krasniqi

Dizajni: Envinion

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e SlovakAid – Ndhimja Zyrtare për Zhvillim e Republikës së Sllovakisë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	8
HYRJE	9
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	10
RENDITJA E KOMUNAVE.....	14
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	16
LISTA E TREGUESVE.....	20
ANALIZA KRAHASIMORE 2014-2021	31
PROKURIMI PUBLIK NË NIVEL KOMUNAL	36
BUXHETIMI DHE FINANCAT PUBLIKE	40
QASJA NË DOKUMENTE DHE INFORMACIONIN PUBLIK	43
PJESËMARRJA PUBLIKE	45
GRANTET DHE SUBVENZIONET.....	47
ETIKA PROFESIONALE DHE KONFLIKTI I INTERESIT	49

MENAXHIMI I PRONËS KOMUNALE DHE ANKANDET.....	51
NDËRMARRJET DHE ORGANIZATAT KOMUNALE.....	52
PËRFUNDIMET	54
REKOMANDIMET	55
REKOMANDIMET PËR QEVERISJEN E NIVELIT QENDROR.....	57


“

UNË BESOJ SE TRANSPARENCA NË
QEVERISJE ËSHTË ÇELËSI PËR TË
RIKTHYER BESIMIN E QYTETARËVE
TONË NË UDHËHEQËSIT E TYRE TË
ZGJEDHUR.”

KIRSTEN GILLIBRAND
SENATORE, SH.B.A.

LISTA E SHKURTESAVE

UA	Udhëzim Administrativ
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
LPP	Ligji për Prokurimin Publik
IPP	Indeksi i prokurimit publik
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
E-PROKURIMI	Platforma elektronike e prokurimit publik
MPL	Ministria e Pushtetit Lokal
MAP	Ministria e Administratës Publike
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MF	Ministria e Financave
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
TI	Transparency International
TIK	Transparency International Kosovë



HYRJE

Qeveria e nivelit lokal është kontakti i parë i qytetarëve me shtresat udhëheqëse duke e bërë të ndjëjë direkt arritjet apo dështimet e institucioneve lokale. Një rrugë e prishur, një projekt i stërzgatur, mbeturinat e pambledhura, bora e papastuar, janë vetëm disa nga shembujt e ballafaqimeve të përditëshme, e që përfundimisht ndikojnë në uljen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike, shto kësaj edhe perceptcionin e lartë për korrupsion të përhapur në shpenzimet publike. Sa më të mbyllura që janë institucionet, aq më shumë ngiten dyshime dhe rritet paknaqësia e qytetarëve.

Transparenca e lartë institucionale ndihmon në rritjen e besimit në qeverisje të mirë përmes llogaridhënies në aktivitetet publike. Por transparenta pa përfshirjen e qytetarëve në proceset zhvillimore dhe informimin e qytetarëve mund të mos tregohet e suksesshme në këtë subjekt duke pasur në konsideratë volumin e informacionit dhe kompleksitetin e tyre, por edhe nevojat e qytetarëve. Për më shumë, në rrugën e përafrimit të qytetarëve me qeveritë lokale, rritjen e efikasitetit dhe efikasitetin e shpenzimeve publike, stimulimin e konkurrencës së lirë dhe zhvillimit ekonomik në nivel lokal, është me rëndësi të veçantë që institucionet të posedojnë instrumentet që mbojnë integritetin dhe etikën institucionale. Një nga elementët kyç në këtë drejtim është edhe eliminimi i ndikimit politik dhe përfaqësimi profesional dhe dinjitoz edhe në ndërmarrjet dhe organizatat komunale, të cilat nëse udhëhiqen me sukses mund të jenë shumë frytëdhënëse jo vetëm për qytetarët por edhe vet institucionet, ose në të kundërtën mund të jenë të dëmshme si në ofrimin e shërbimeve, po ashtu edhe në rritjen e barrës financiare të komunave. Për më shumë, rritja e

transparencës dhe qytetaria aktive i ndihmojnë edhe vet institucioneve në përmirësimin dhe avansimin e performancës së tyre.

Për të shtatin vit radhazi, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) / Transparency International Kosova (TIK), përmes publikimit të Indeksit të Transparencës në qeverisjen lokale, vazhdon të hedh dritë mbi shpenzimet komunale dhe duke inkurajuar institucionet që të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët dhe promovimin e një qytetarie aktive. Qëllimi i këtij Indeksi është të informojë qytetarët për nivelin e transparencës dhe efikasitetit me të cilat qeveritë lokale ofrojnë mallra, punë dhe shërbime, dhe të inkurajojë institucionet për të kryer planifikim dhe shpenzime financiare më efikase dhe transparente sipas nevojane të komunitetit.





PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në vitin 2021 edhe pse duke u përballur me sfidat ekonomike të shkaktuara nga pandemia COVID-19, si dhe zgjedhjet e parakohëshme të nivelit qendror dhe zgjedhjet lokale, komunat u treguan mjaft proaktive dhe llogaridhënëse ndaj qytetarëve të saj.

Me qëllim të stimulimit të komunave sa më transparente, në vitin 2021, KDI ka adaptuar edhe 46 tregues të rinj nga metogologjia e Transparency International Sllovakia, e adaptuar nga shumë degë të Transparency International në Bashkimin evropian duke përfshirë edhe Kosovën në vitin 2017, duke e rritur kështu numrin e treguesëve të përdorur gjatë periudhës 2017 – 2020 nga 41 në 87, të shtrirë në **tetë politika publike** si prokurimi publik në nivel komunal, buxheti dhe financat publike, qasjen në dokumente dhe informacion publik, pjesëmarrjen publike, grantet dhe subvencionet, etikën profesionale dhe konfliktin e interesit, menaxhimin e pronës publike dhe ndërmarrjet dhe organizatat komunale. Nga **87 treguesit e indeksit**, 51 prej të cilëve janë tregues të produktit që matin nëse aktivitetet dhe veprimet e planifikuara janë duke u zbatuar siç janë parashikuar ose siç kërkohet nga ligji dhe 12 tregues të performancës që matin cilësinë e produktit/aktivitetit të komunës dhe 24 indikatorë komplementues të cilët nuk kanë pikë, por komplementojnë historikun e indikatorëve të tjerë.

Ndonëse në vitin 2021, pjesa më e madhe e matjeve janë të bazuara në tregues të rinj, indeksi na jep një rezultat të knaqshëm me një mesatare prej **56%** në tetë politikat publike të trajtuara.

Viti 2021 tregoi një trend pozitiv në transparencën në prokurimin publik në nivel komunal duke shënuar një **rritje prej rreth 13%** në krahasim të treguesëve të njejtë brenda kësaj politike qeverisëse nga mesatarja prej 57% në vitin 2020 në mesataren prej 70% në vitin 2021. Gjatë vitit 2021, 30 nga 38 komunat kanë publikuar planifikimin e prokurimit në ueb faqe, nga të cilat 19 ishin në format të lexueshëm (Word, Excel, PDF Machine Readable), 26 nga 38 komunat kanë publikuar në faqen e internetit raportin vjetor të prokurimit për vitin e kaluar, nga të cilat 20 ishin në format të lexueshëm dhe gjashtë ishin dokumente të skanuara, 32 kanë publikuar një listë të të gjitha organeve ekzekutive, institucioneve publike dhe organizatave, të cilat i rregullojnë ose trajtojnë këshillat dhe kontestet e prokurimit, por vetëm katër kishin dhënë edhe një përkrahim të përgjegjësive të këtyre institucioneve, 28 komuna i publikojnë njoftimet për kontratë në ueb faqe, por vetëm 15 nga to publikojnë 100% të njoftimeve në krahasim me publikimet në e-Prokurimi, 26 komuna publikojnë njoftimet për dhënie të kontratës në ueb faqe por vetëm 12 komuna bëjnë publikimin e njoftimeve për dhënie të kontratës në ueb faqe kundrejt e-Prokurimit.





Një **rritje prej 9%** ishte shënuar edhe në transparencën buxhetore (nga 64% në 2020 në 73% në 2021). 23 komuna nga 38 kishin publikuar planin e investimeve komunale në faqen e internetit, 26 komuna kishin publikuar buxhetin në ueb faqe të komunës, 19 komuna kishin publikuar ndryshimet në ndarjet buxhetore në ueb faqe të komunës, 17 komuna kishin publikuar të gjitha raportet tremujore të shpenzimeve në faqen e internetit dhe 11 pjesërisht, 29 komuna kishin publikuar raportin përmbledhës vjetor për buxhetin e komunës për vitin paraprak fiskal në faqen e internetit, 30 komuna kishin publikuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, si dhe 28 komuna kishin publikuar raportet e auditorit në faqen e internetit


KDI inkurajon të gjitha komunat të vazhdojnë me dedikimin e tyre në rritjen e transparencës dhe të rishikojnë mangësitë e tyre në këtë indeks për vitin 2021 dhe të përqendrohen në rritjen e transparencës në të gjitha shtyllat në 2022.

Në vitin 2021, kishte një rritje të kërkesave për dokumente publike **nga 327 në vitin 2020 në 745 në 2021**. Nga këto kërkesa, 359 ishin lidhur me procedurat e prokurimit publik. Po ashtu, kishte një rritje e numrit të komunave që iu përgjigjën kërkesës së KDI-së për informacion dhe bazuar në informacionin e marrë nga 34 komuna 13 ishin refuzuar për shkak të mbrojtjes të së dhënave private.





Në vitin 2021, pjesa më e madhe e matjeve janë të bazuara në tregues të rinj, indeksi na jep një rezultat të knaqshëm me një mesatare prej **56%** në tetë politikat publike të trajtuara.





TRANSPARENCA E PËRGJITHSHME E KOMUNAVE NË GJASHTË SHTYLLA

RENDITJA E KOMUNAVE



0 KOMUNA MË SË PAKU
TRANSPARENTE

KOMUNA MË
TRANSPARENTE 100

|||||

Komuna / Politika qeverisëse	Prokurimi Publik në nivel komunal	Buxheti dhe financat publike	Qasja në dokumente dhe informacionin publik	Pjesëmarrja publike	Grantet dhe Subvencionet	Etika Profesionale dhe Konflikti i Interesit	Menaxhimi i pronës komunale dhe Ankaudet	Ndërmarrjet dhe organizatat komunale	PIKËT E PËRGJITHSHME PËR KOMUNË
17 Hani i Elezit	9.75	10.38	12.69	9	8.89	6	5	2.5	64.22
18 Dragash	13.43	9.23	12.69	12	8.89	0	5	2.5	63.74
19 Junik	12	9.81	12.69	3	7.78	6	10	1.25	62.53
20 Kamenicë	10.8	8.65	12.69	6	8.89	2	10	2.5	61.54
21 Klinë	14.25	6.35	12.69	4.5	6.67	6	5	2.5	57.96
22 Obiliq	9.08	9.23	12.69	7.5	8.89	4	5	1.25	57.64
23 Viti	9.38	8.65	12.69	4.5	8.89	2	10	1.25	57.36
24 Istog	12.3	8.08	12.69	4.5	6.67	6	5	1.88	57.11
25 Deçan	10.43	8.65	10.96	7.5	6.67	6	5	1.88	57.08
26 Mamushë	14.25	9.81	12.69	6	4.44	2	5	1.88	56.07
27 Fushë Kosovë	5.25	9.81	12.69	6	7.78	0	10	1.88	53.40
28 Malishevë	6.75	8.08	12.69	7.5	8.89	4	0	2.5	50.41
29 Klllokot	8.18	8.65	12.69	0	6.67	2	5	1.25	44.44
30 Graçanicë	5.33	4.04	12.69	6	3.33	4	5	1.25	41.64
31 Shtërpçë	0	6.92	12.69	6	3.33	6	5	1.25	41.20
32 Novo Bërdë	0.75	4.04	12.69	0	3.33	0	5	1.88	27.69
33 Ranillug	0	6.92	12.69	3	2.22	0	0	1.25	26.09
34 Partesh	3.75	1.15	9.23	0	2.22	2	0	1.25	19.61
35 Zubin Potok	0	1.15	1.15	3	0	0	0	0	5.31
36 Zvecan	0	1.15	1.15	3	0	0	0	0	5.31
37 Mitrovicë e Veriut	0.75	1.73	2.31	0	0	0	0	0	4.79
38 Leposaviq	0	1.15	1.15	0	0	0	0	0	2.31

0

KOMUNA MË SË PAKU
TRANSPARENTEKOMUNA MË
TRANSPARENTE

100

|||||

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), kapitulli i Transparency International (TI) për Kosovën në bashkëpunim me Transparency International Shlovalia, e cila është lidere në promovimin e transparencës në qeverisje lokale në nivel të gjithë evropës, gjatë vitit 2021 kanë konsultuar nga afër politikat publike dhe mundësitë e gjerimit të indikatorëve matës me qëllim të stimulimit të rritjes edhe të mëtutjeshme të transparencës në nivel komunal, e nga e cila përfundimisht do të përfitonin qytetarët e tyre.

Kjo metodologji e përmirësuar e vlerësimit pasuron indeksin e transparencës në qeverisjen lokale për 46 indikatorë të rinjë dhe dy shtylla shtesë (1) menaxhimi i pronës komunale dhe ankandet dhe (2) Ndërmarrjet dhe organizatat komunale.

Për Indeksin e Transparencës në Prokurimin Publik për vitin 2021, KDI ka vlerësuar transparencën institucionale të komunave të Kosovës kundrejt 87 treguesve, të grupuar në tetë shtylla tematike.

Duke qenë që ky është viti i parë i matjes së transparencës në 46 indikatorë të rinjë, ky indeks i vitit 2021 do të shërbejë si bazë për matjet dhe krahasimet në vitet në vijim. Metodologjia e përdorur në vitin 2021 është thjesht reflektim i metodologjisë së përdorur në vitin 2020 dhe matjet paraprake që nga viti 2017.

Meqenëse numri i treguesve dhe pikëve për tregues nuk japin rezultatin maksimal të kombinuar prej 100, rezultati i ponderuar është përdorur për rezultatet numerike që i mundësojnë KDI-së ta rangojë performancën bazuar në kategoritë e niveleve të ndryshme të prioriteteve ose rëndësisë. Numri i treguesve, pikët maksimale për treguesit për shtyllë dhe pesha e secilës shtyllë janë paraqitur në tabelën më poshtë.

|||||

Politika publike në nivel komunal	Numri i treguesve	Pikët maksimale të treguesve	Pikët maksimale të ponderuara sipas shtyllës
PROKURIMI PUBLIK NË NIVEL KOMUNAL	17	24	15
BUXHETIMI DHE FINANCAT PUBLIKE	20	20	15
QASJA NË DOKUMENTE DHE INFORMACIONIN PUBLIK	15	26	15
PJESËMARRJA PUBLIKE	8	14	15
GRANTET DHE SUBVENZIONET	10	20	10
ETIKA PROFESIONALE DHE KONFLIKTI I INTERESIT	6	12	10
MENAXHIMI I PRONËS KOMUNALE DHE ANKANDET	3	4	10
NDËRMARRJET DHE ORGANIZATAT KOMUNALE	8	14	10
TOTAL	87	134	100

*** Për shkak të mos funksionimit të Organit Shqyrtues së Prokurimit, në indeksin e vitit 2021, indikatori "A i publikon komuna vendimet e OSHP-së në ueb faqen e saj?" nuk është matur, dhe pikët maksimale të treguesëve në politikat e transparencës në prokurimin publik janë llogaritur në total 20.

|||||



1. Treguesit e Produktit – Ekzistojnë tregues të produktit që e matin nëse aktivitetet dhe veprimet e planifikuara po zbatohen në të vërtetë siç është paraparë ose siç kërkohet me ligj. Këta tregues mbështeten në të dhënat e nxjerra nga burime të fuqishme dhe të verifikueshme, siç janë faqet e internetit të qeverisë komunale ose qendrore. Këta tregues marrin vlera nga 0 deri në 2 pikë, siç janë shënuar më poshtë:

- 0 Pikë** – që tregojnë se nuk ka informata
- 1 Pikë** – që tregon se informatat janë shpalosur pjesërisht
- 2 Pikë** – që tregojnë se informatat janë shpalosur plotësisht

2. Treguesit e Performancës – Janë 12 tregues të performancës që e matin cilësinë e performancës. Anketuesit e KDI-së janë mbështetur në këta tregues për t'i krahasuar të dhënat dhe për të përcaktuar një përqindje të performancës. Për t'i krahasuar pikët numerike të treguesve të tjerë, këta tregues janë vlerësuar siç është përshkruar në tabelën e mëposhtme:

KRAHASIMI I TË
DHËNAVE KOMUNA
KUNDREJT BURIMEVE
ALTERNATIVE NË
PËRQINDJE



|||||

ID	Pozita e treguesit	Treguesi	Politika	Pikët maksimale	Rezultati	Burimi
K21010	Kryesor	A ka komuna gazetë komunale?	Qasja në dokumente dhe informacionin publik	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21011	Kryesor	A funksionon "search bar"	Qasja në dokumente dhe informacionin publik	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21012	Kryesor	Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike	Qasja në dokumente dhe informacionin publik	2	PO/JO	Kërkesë manuale
K21013	Mbështetës - nëntregues për K21012	Numri i kërkesave të refuzuara dhe heshtja administrative (mos përgjigja)	Qasja në dokumente dhe informacionin publik	2	PO/JO	Kërkesë manuale
K21014	Kryesor	Numri i kërkesave në lidhje me prokurimin publik	Qasja në dokumente dhe informacionin publik	2	PO/JO	Kërkesë manuale
K21015	Mbështetës - nëntreguesi për K21014	Numri i kërkesave të refuzuara në lidhje me prokurimin publik	Qasja në dokumente dhe informacionin publik	2	PO/JO	Kërkesë manuale
K21016	Kryesor	A udhëhiqen ndryshimet e buxhetit nga të njëjtat rregulla si për propozimin e buxhetit (p.sh. Publikimi i draft ndryshimeve për konsultim publik.)?	Buxhetimi dhe financat publike	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21017	Kryesor	A janë të publikuara ndryshimet në buxhet të cilat pasqyrojnë investimet nga të hyrat vetanake komunale në ueb faqen e internetit	Buxhetimi dhe financat publike	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës

|||||

INDEKSI I TRANSPARENÇES PËR QEVERISJEN KOMUNALE 2021

|||||

ID	Pozita e treguesit	Treguesi	Politika	Pikët maksimale	Rezultati	Burimi
K21018	Kryesor	A janë të disponueshme në faqen e internetit buxhetet e të paktën tre viteve të fundit?	Buxhetimi dhe financat publike	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21019	Mbështetës - nëntreguesi për K21018	A është buxheti aktual i komunës i disponueshëm në faqen e internetit?	Buxhetimi dhe financat publike	N/A	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21020	Mbështetës - nëntreguesi për K21018	A është buxheti i vitit 2020 i disponueshëm në faqen e internetit?	Buxhetimi dhe financat publike	N/A	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21021	Mbështetës - nëntreguesi për K21018	A është buxheti i vitit 2019 i disponueshëm në faqen e internetit?	Buxhetimi dhe financat publike	N/A	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21022	Kryesor	A janë të disponueshme në faqen zyrtare të internetit raportet vjetore të buxhetit për tri vitet e fundit radhazi?	Buxhetimi dhe financat publike	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21023	Mbështetës - nëntreguesi për K21022	A është raporti vjetor i buxhetit për vitin 2020 i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit?	Buxhetimi dhe financat publike	N/A	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21024	Mbështetës - nëntreguesi për K21022	A është raporti vjetor i buxhetit për vitin 2019 i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit?	Buxhetimi dhe financat publike	N/A	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21025	Mbështetëse	A është raporti vjetor i buxhetit për vitin 2018 i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit?	Buxhetimi dhe financat publike	N/A	PO/JO	Ueb faqja e komunës

|||||

|||||

ID	Pozita e treguesit	Treguesi	Politika	Pikët maksimale	Rezultati	Burimi
K21026	Kryesor	A janë të publikuara raportet e shpenzimeve për vitin aktual në ueb faqen e internetit	Buxhetimi dhe financat publike	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21027	Mbështetës - nëntreguesi për M18026	A është publikuar raporti përmbledhës për buxhetin e komunës për vitin fiskal paraprak në ueb faqen e internetit	Buxhetimi dhe financat publike	N/A	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21028	Mbështetës - nëntreguesi për M18026	A është i publikuar raporti i tremujorit të parë të shpenzimeve për vitin aktual në ueb faqen e internetit	Buxhetimi dhe financat publike	N/A	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21029	Mbështetës - nëntreguesi për M18026	A është i publikuar raporti i tremujorit të dytë të shpenzimeve për vitin aktual në ueb faqen e internetit?	Buxhetimi dhe financat publike	N/A	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21030	Mbështetës - nëntreguesi për M18026	A është i publikuar raporti i tremujorit të tretë të shpenzimeve për vitin aktual në ueb faqen e internetit?	Buxhetimi dhe financat publike	N/A	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21031	Kryesor	A është e publikuar korniza afatmesme buxhetore në faqen e internetit?	Buxhetimi dhe financat publike	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21032	Kryesor	A është e publikuar korniza afatmesme buxhetore në format të përshtatshëm për përdoruesit (word, excel, cvs, etj)	Buxhetimi dhe financat publike	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21033	Kryesor	A e përfshin korniza buxhetore afatmesme buxhetimin gjinor?	Buxhetimi dhe financat publike	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës

|||||



ID	Pozita e treguesit	Treguesi	Politika	Pikët maksimale	Rezultati	Burimi
K21034	Kryesor	A është plani i investimeve i publikuar në faqen e internetit?	Buxhetimi dhe financat publike	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21035	Kryesor	A është raporti i auditimit në ueb faqen e internetit?	Buxhetimi dhe financat publike	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21036	Kryesor	A mundet publiku të marrë pjesë në të gjitha seancat ku diskutohet ose vendoset për ndarjen e granteve?	Grantet dhe Subvencionet	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21037	Kryesor	A janë të disponueshme në faqen zyrtare të internetit rregullat që rregullojnë konfliktin e mundshëm të interesit mes anëtarëve të vlerësuese për ndarjen e granteve?	Grantet dhe Subvencionet	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21038	Kryesor	A janë të disponueshme në faqen e internetit të komunës kriteret specifike për dhënien e granteve?	Grantet dhe Subvencionet	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21039	Kryesor	A janë të disponueshme në faqen zyrtare të internetit vendimet për dhënien/refuzimin e ndarjes së grantit?	Grantet dhe Subvencionet	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21040	Kryesor	A ekziston në faqen zyrtare të internetit arkivi i vendimeve për dhënien / refuzimin e ndarjes së grantit për dy vitet e fundit?	Grantet dhe Subvencionet	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21041	Kryesor	A janë publikuar raportet e vlerësimit për dhënien e granteve në ueb faqen e internetit?	Grantet dhe Subvencionet	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës



|||||

ID	Pozita e treguesit	Treguesi	Politika	Pikët maksimale	Rezultati	Burimi
K21042	Kryesor	A ka në dispozicion në faqen e internetit të komunës informata për subvencione të ndara nga komuna?	Grantet dhe Subvencionet	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21043	Kryesor	A jep komuna informata për shumën e grantve dhe subvencioneve për vitin paraprak?	Grantet dhe Subvencionet	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21044	Kryesor	A është publikuar raporti vjetor për vitin paraprak mbi subvencionet e dhëna në ueb faqen e internetit?	Grantet dhe Subvencionet	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21045	Kryesor	A janë publikuar rregulloret për dhënien e granteve në ueb faqen e internetit?	Grantet dhe Subvencionet	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21046	Kryesor	A është legjislacioni bazë për organizimin, funksionimin dhe funksionet e ndërmarrjeve publike dhe institucioneve të varura i publikuar në faqen e internetit	Ndërmarrjet dhe organizatat komunale	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21047	Kryesor	A është skema organizative për përfshirjen e ndërmarrjeve publike dhe institucioneve të varura e publikuar në faqen e internetit	Ndërmarrjet dhe organizatat komunale	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21048	Kryesor	A janë të disponueshme raportet financiare vjetore të të gjitha ndërmarrjeve publike të publikuara në ueb faqe të komunës?	Ndërmarrjet dhe organizatat komunale	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21049	Kryesor	A janë faqet individuale të internetit të ndërmarrjeve dhe organizatave komunale të ndërlidhura me komunën të ndërlidhura me faqen zyrtare të komunës apo e kanë seksionin e tyre në faqen e internetit të komunës?	Ndërmarrjet dhe organizatat komunale	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës

|||||



ID	Pozita e treguesit	Treguesi	Politika	Pikët maksimale	Rezultati	Burimi
K21050	Kryesor	Numri i kompanive me investime komunale	Ndërmarrjet dhe organizatat komunale	N/A	PO/JO	Kërkesë manuale
K21051	Kryesor	A janë të disponueshme në faqen e internetit të komunës biografitë e udhëheqësve të departamenteve, përfshirë informatat për: i. arsimimin ii. punësimin e mëparshëm	Ndërmarrjet dhe organizatat komunale	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21052	Kryesor	A janë të disponueshme biografitë e bordit drejtues të ndërmarrjeve komunale publike në faqen e internetit të komunës përfshirë informatat për arsimin?	Ndërmarrjet dhe organizatat komunale	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21053	Kryesor	A ka dhënë komuna infomata lidhur me buxhetet e DKA për shkollat në juridiksioin e saj?	Ndërmarrjet dhe organizatat komunale	2	PO/JO	Kërkesë manuale
K21054	Kryesor	A ka komuna kodin e etikës për punonjësit e vet?	Etika profesionale dhe konflikti i interesave	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21055	Kryesor	A janë të disponueshme në faqen zyrtare procesverbalet nga seancat e komisionit për interesin e publikut?	Etika profesionale dhe konflikti i interesave	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21056	Kryesor	A janë të disponueshme në faqen zyrtare të komunës deklaratat e pasurisë së kryetarit?	Etika profesionale dhe konflikti i interesave	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës



|||||

ID	Pozita e treguesit	Treguesi	Politika	Pikët maksimale	Rezultati	Burimi
K21057	Kryesor	A ekziston ndonjë instrument specifik për raportimin e sjelljeve joetike (p.sh. linja telefonike, formulari online, komisioneri për etikë etj.) brenda zyrës së komunës? Nëse po, çfarë është?	Etika profesionale dhe konflikti i interesave	2	PO/JO	Kërkesë manuale
K21058	Kryesor	Sa raste të sinjalizimit apo raportimit të konfliktit të interesit ka pasur komuna nga viti 2021?	Etika profesionale dhe konflikti i interesave	2	PO/JO	Kërkesë manuale
K21059	Kryesor	A e ka të publikuar komuna planin e integritetit në faqen e internetit?	Etika profesionale dhe konflikti i interesave	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21060	Kryesor	A ka ndonjë instrument online që i mundëson publikut t'i paraqesë dhe t'i gjurmojë ankesat/ shqetësimet / pyetjet e tyre?	Pjesëmarrja publike	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21061	Kryesor	Sa shpesh e përdorin qytetarët ueb faqen e komunës?	Pjesëmarrja publike	N/A	PO/JO	Kërkesë manuale
K21062	Kryesor	A është i publikuar projektbuxheti për konsultime publike?	Pjesëmarrja publike	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21063	Kryesor	A janë publikuar draftet e vendimeve të kryetarit të komunës për konsultim me publikun?	Pjesëmarrja publike	2	PO/JO	e-prokurimi
K21064	Kryesor	A publikohen draftet e agjendave të kryetarit për konsultim me publikun?	Pjesëmarrja publike	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës

|||||

INDEKSI I TRANSPARENCËS PËR QEVERISJEN KOMUNALE 2021

|||||

ID	Pozita e treguesit	Treguesi	Politika	Pikët maksimale	Rezultati	Burimi
K21065	Kryesor	A mund t'i dërgosh komunës letër online me pyetje?	Pjesëmarrja publike	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21066	Kryesor	Numri i dëgjimeve buxhetore nga zyra e kryetarit (min. 1 për vit)	Pjesëmarrja publike	2	PO/JO	Kërkesë manuale
K21067	Kryesor	Numri i dëgjimeve buxhetore nga Kuvendi Komunal (min. 1 për vit)	Pjesëmarrja publike	2	PO/JO	Kërkesë manuale
K21068	Kryesor	A është plani i prokurimit publik për vitin aktual i disponueshëm në faqen e internetit të komunës?	Prokurimi Publik në nivel komunal	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21069	Kryesor	A është i publikuar plani i prokurimit në format miqësor për përdoruesit, (Word, Excel, Cvs)?	Prokurimi Publik në nivel komunal	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21070	Kryesor	A është publikuar raporti vjetor i prokurimit për vitin paraprak në format miqësor për përdoruesit, (Word, Excel, Cvs)?	Prokurimi Publik në nivel komunal	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21073	Kryesor	A ka një listë të të gjitha organeve ekzekutive, institucioneve publike dhe organizatave të cilat i rregullojnë ose trajtojnë këshillat dhe kontestet e prokurimit?	Prokurimi Publik në nivel komunal	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21074	Kryesor	A i publikon komuna kontratat në ueb faqen e saj?	Prokurimi Publik në nivel komunal	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës

|||||

|||||

ID	Pozita e treguesit	Treguesi	Politika	Pikët maksimale	Rezultati	Burimi
K21075	Kryesor	Numri i kontratave të publikuara në faqen e internetit të komunës	Prokurimi Publik në nivel komunal	SHUMA e kontratave të publikuara	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21076	Kryesor	A janë njoftimet për kontratë për vitin aktual të disponueshme në faqen zyrtare të internetit?	Prokurimi Publik në nivel komunal	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21077	Kryesor	Numri i njoftimeve për kontratë në ueb faqen e komunës	Prokurimi Publik në nivel komunal	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21078	Mbështetës	Numri i njoftimeve për kontratë në ueb faqen e KRPP-së	Prokurimi Publik në nivel komunal	2	PO/JO	e-prokurimi
	nën-treguesi për K21077					
K21079	Kryesor	A janë të disponueshme njoftimet për dhënien e kontratave për vitin aktual në faqen zyrtare të internetit?	Prokurimi Publik në nivel komunal	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21080	Kryesor	Numri i njoftimeve për dhënien e kontratave në ueb faqen e komunës	Prokurimi Publik në nivel komunal	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21081	Mbështetës - nëntreguesi për K21080	Numri i njoftimeve për dhënien e kontratave në ueb faqen e KRPP-së	Prokurimi Publik në nivel komunal	N/A	PO/JO	e-prokurimi

|||||

INDEKSI I TRANSPARENÇËS PËR QEVERISJEN KOMUNALE 2021

|||||

ID	Pozita e treguesit	Treguesi	Politika	Pikët maksimale	Rezultati	Burimi
K21082	Kryesor	A është i publikuar raporti vjetor i prokurimit për vitin paraprak në ueb faqen e internetit?	Prokurimi Publik në nivel komunal	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21083	Kryesor	A i publikon komuna vendimet e OSHP-së në ueb faqen e saj?	Prokurimi Publik në nivel komunal	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21084	Kryesor	Numri i vendimeve të OSHP-së të publikuara në ueb faqen e komunës	Prokurimi Publik në nivel komunal	N/A	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21071	Kryesor	Numri i ankesave të OSHP-së të parashtruara kundër vendimeve komunale për veprimet e prokurimit	Prokurimi Publik në nivel komunal	N/A	PO/JO	ueb faqja e OSHP
K21072	Mbështetës - nëntreguesi për K21071	Numri i ankesave të OSHP-së të parashtruara kundër vendimeve komunale për veprimet e prokurimit	Prokurimi Publik në nivel komunal	N/A	PO/JO	ueb faqja e OSHP
K21085	Kryesor	A janë rregulloret për menaxhimin e pronës të disponueshme në faqen zyrtare të internetit?	Menaxhimi i pronës komunale dhe ankandet	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21086	Kryesor	Numri i njoftimeve për ankande në faqen e internetit të komunës	Menaxhimi i pronës komunale dhe ankandet	2	PO/JO	Ueb faqja e komunës
K21087	Mbështetës - nëntreguesi për K21086	Numri i njoftimeve për ankande në ueb faqen e KRPP-së	Menaxhimi i pronës komunale dhe ankandet	N/A	PO/JO	e-prokurimi

|||||



ANALIZA KRAHASIMORE 2014-2021

Në vitin 2021, KDI-ja prezantoi një metodologji të rishikuar që mat tetë shtylla që kanë të bëjnë transparencën në prokurimin publik, shpenzimet publike, qasjen në dokumente dhe informacionin publik, pjesëmarrjen publike, grantet dhe subvencionet, instrumentet për adresimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit në qeverisjen lokale, menaxhimin e pronës komunale dhe ankandet, si dhe ndërmarrjet dhe organizatat komunale. E njëjta metodologji është përdorur për masat e vitit 2021. Megjithëse KDI-ja e modifikoi metodologjinë për të matur transparencën në prokurimin publik në nivelin e qeverisjes lokale duke prezantuar gjashtë shtylla dhe 41 tregues, ajo prapë i ka mbajtur 19 treguesit fillestarë që janë përdorur në vitet e mëparshme, për t'i mundësuar hulumtuesve të vazhdojnë t'i matin trendet kohore kundrejt atyre 19 treguesve.




- | | | | |
|----|--|----|---|
| 1 | Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike, në çdo fushë; | 11 | Numri i tenderëve të publikuar në faqen e internetit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik; |
| 2 | Numri i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumente publike, në çdo fushë; | 12 | Numri i kontratave të dhëna të publikuara në faqen e internetit të komunës (njoftimet për dhënie të kontratës); |
| 3 | Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike në prokurimin publik; | 13 | Numri i kontratave të dhëna të publikuara në faqen e internetit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik; |
| 4 | Numri i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumente publike në fushën e prokurimit publik; | 14 | Njoftime për shpalljen e ankandit publik në faqen e internetit të komunës; |
| 5 | Publikimi i buxhetit të miratuar në faqen e internetit të komunës; | 15 | Njoftime për shpalljen e ankandit publik në faqen e internetit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik; |
| 6 | Publikimi i planit të prokurimit në faqen e internetit të komunës; | 16 | Njoftimi i fituesve të ankandit në faqen e internetit të komunës; |
| 7 | Publikimi i raportit të auditimit në faqen e internetit të komunës; | 17 | Njoftimi i fituesve të ankandit në faqen e internetit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik; |
| 8 | Numri i seancave dëgjimore publike; | 18 | Numri i kërkesave/ankesave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë për t'i shqyrtuar dhënie të kontratave; |
| 9 | Publikimi i raporteve financiare tremujore dhe gjysmë-vjetore/vjetore në faqen e internetit; | 19 | Numri i vendimeve (përgjigjeve) për kërkesat për rishikim. |
| 10 | Numri i tenderëve të publikuar në faqen e internetit të komunës (njoftimet për kontratë); | | |



Grafiku më poshtë tregon trendet e transparencës në prokurimin publik gjatë viteve 2014-2021.


Transparenca në Prokurim krahasimi përgjatë viteve 2015-2021






Grafiku më poshtë tregon trendet e transparencës buxhetore përgjatë viteve 2015-2020.

Transparenca Buxhetore 2015-2021




Grafiku i mëposhtëm tregon trendet e transparencës përgjatë viteve 2015 - 2021 në publikimin e njoftimeve për ankande nga komunat.

Trendet e publikimit të ankandeve publike në uebfaqen e komunës 2015-2021



Kërkesat për qasje në dokumentet publike që kanë të bëjnë me prokurimin publik





Siç mund ta shohim nga grafikët e mësipërm, në vitin 2021, kishte përgjithësisht një rritje të transparencës në **19** treguesit e përmendur më lart.

- 1 Në vitin 2021, ka pasur një rritje mesatare prej rreth **21%** në transparencën në prokurimin publik në krahasim me vitin 2020 (në dy indikatorët historik).
- 2 Për më tepër në vitin 2021, ka pasur një rritje mesatare prej rreth **5%** në krahasim me vitin 2020 në transparencën buxhetore në tre indikatorët historik.
- 3 Në publikimin e njoftimeve për ankande për vitin 2021, **64 njoftime** u botuan në faqet e internetit të komunave por vetëm 10 në faqen e internetit të KRPP-së.
- 4 Në krahasim me vitin 2020, i cili ishte një vit pandemik (COVID-19), numri i kërkesave për qasje në dokumente publike ishte rritur për **386 kërkesa**.



SHTYLLA I

PROKURIMI PUBLIK NË NIVEL KOMUNAL

Në vitin 2021, vetëm 18% e buxhetit publik të Kosovës është shpenzuar nëpërmjet prokurimit publik⁹. Megjithatë, ky proces në Kosovë vazhdon të shihet si një nga politikat publike me rrezikun më të lartë për korrupsion. Kosova gjatë viteve të fundit ka ndërmarr disa iniciative për rritjen e transparencës në këtë politikë publike, duke për obligative edhe publikimin e kontratave dhe kushteve të veçanta të obligueshme në platformën qendrore të prokurimit publik. Megjithatë, kontakti i parë i qytetarit me qeverisjen është komuna. Për të vlerësuar nivelin e transparencës në këtë politikë publike, KDI ka matur 14 treguesit si në vijim:

- 1 A është plani i prokurimit publik për vitin aktual i disponueshëm në faqen e internetit të komunës?
- 2 A është i publikuar plani i prokurimit në format miqësor për përdoruesit, (Word, Excel, Cvs)?
- 3 A është publikuar raporti vjetor i prokurimit për vitin paraprak në format miqësor për përdoruesit, (Word, Excel, Cvs)?
- 4 A ka një listë të të gjitha organeve ekzekutive, institucioneve publike dhe organizatave të cilat i rregullojnë ose trajtojnë këshillat dhe kontestet e prokurimit?
- 5 A i publikon komuna kontratat në ueb faqen e saj?
- 6 Numri i kontratave të publikuara në faqen e internetit të komunës
- 7 A janë njoftimet për kontratë për vitin aktual të disponueshme në faqen zyrtare të internetit?
- 8 Numri i njoftimeve për kontratë në ueb faqen e komunës
- 9 Numri i njoftimeve për kontratë në ueb faqen e KRPP-së

#	Komuna	Pikët
1	Gjakovë	15.00
1	Prishtinë	15.00
2	Ferizaj	14.25
2	Klinë	14.25
2	Mamushë	14.25
2	Pejë	14.25
2	Rahovec	14.25
3	Lipjan	13.50
3	Podujevë	13.50
4	Dragash	13.43
5	Kaçanik	12.75
6	Prizren	12.68
6	Suharekë	12.68
7	Istog	12.30
8	Junik	12.00
8	Shtime	12.00
9	Vushtrri	11.93
10	Mitrovicë	11.25
11	Kamenicë	10.80
12	Deçan	10.43
13	Skenderaj	10.20
14	Gjilan	9.75
14	Hani i Elezit	9.75
15	Drenas	9.38
15	Viti	9.38
16	Obiliq	9.08
17	Kllokot	8.18
18	Malishevë	6.75
19	Graçanicë	5.33
20	Fushë Kosovë	5.25
21	Partesh	3.75
22	Mitrovicë e Veriut	0.75
22	Novo Bërdë	0.75
23	Leposaviq	0.00
23	Ranillug	0.00
23	Shtërpçë	0.00
23	Zubin Potok	0.00
23	Zvecan	0.00

|||||

- 10 A janë të disponueshme njoftimet për dhënien e kontratave për vitin aktual në faqen zyrtare të internetit?
- 11 Numri i njoftimeve për dhënien e kontratave në ueb faqen e komunës
- 12 Numri i njoftimeve për dhënien e kontratave në ueb faqen e KRPP-së
- 13 A është i publikuar raporti vjetor i prokurimit për vitin paraprak në ueb faqen e internetit?

Për shkak të mungesës së bordit të Organit Shqyrtues së Prokurimit përgjatë vitit 2021, edhe pse pjesë e metodologjisë së vitit 2021, treguesit në vijim nuk janë matur dhe nuk kanë ndikuar në pikët e komunave sa i përket transparencës në prokurimin publik:

- 1 A i publikon komuna vendimet e OSHP-së në ueb faqen e saj?
- 2 Numri i vendimeve të OSHP-së të publikuara në ueb faqen e komunës
- 3 Numri i ankesave të OSHP-së të parashtruara kundër vendimeve komunale për veprimet e prokurimit
- 4 Numri i vendimeve të OSHP-së kundër vendimeve komunale për veprimet e prokurimit

Pikët maksimale që mund të arrihen në këtë shtyllë janë 15, ndërsa rezultati minimal është zero. Tabela në anën e djathtë tregon radhitjen e komunave sipas rezultateve individuale në këtë shtyllë.


Rezultati mesatar për transparencë të prokurimit publik në nivel komunal është 61%.

Në grafikun në vijim është paraqitur situata aktuale e përgjithshme për të gjitha komunat në këtë proces, sipas aktivitetit dhe në krahasim me trendet e transparencës midis viteve 2019 - 2021:

|||||



Prokurimi publik në nivel komunal 2019-2021



- 30 nga 38 komuna kanë publikuar planet e tyre të prokurimit në ueb faqet e tyre, ndërsa 21 nga to ishin në format të lexueshëm;
- 32 nga 38 komuna kishin publikuar kontakte të organeve ekzekutive, institucioneve publike dhe organizatave që i rregullojnë ose trajtojnë këshillat dhe mosmarrëveshjet e prokurimit në ueb faqet e tyre, megjithatë vetëm katër (4) komuna kishin përshtetur për qytetarët rolet dhe përgjegjësitë e këtyre institucioneve;
- 26 nga 38 komuna kanë publikuar raportin vjetor të prokurimit nga viti paraprak në ueb faqet e tyre, ndërsa 20 nga to ishin në format të lexueshëm;
- 24 nga 38 komuna kanë publikuar të gjitha njoftimet për kontratë, 4 kanë publikuar pjesërisht njoftimet për kontratë në ueb faqet e tyre, ndërsa 10 komuna nuk kanë publikuar asnjë njoftim;
- 22 nga 38 komuna kanë publikuar njoftimet për dhënie të kontratës, 4 kanë publikuar pjesërisht njoftimet për dhënie të kontratës në ueb faqet e tyre, ndërsa 12 komuna nuk kanë publikuar asnjë njoftim;
- 28 nga 38 komuna kanë publikuar kontratat në ueb faqet e tyre.





Përderisa shumica e komunave publikojnë dokumente që kanë të bëjnë me prokurimin publik, janë pesë komuna që gjatë vitit 2021 nuk kishin publikuar asnjë dokumentacion në lidhje me këtë proces. Informacioni për aktivitetet e tyre është në dispozicion vetëm në platformën e prokurimit të qeverisë qendrore.

1 Leposaviq

3 Shtërpçë

5 Zveçan


2 Ranillug

4 Zubin Potok

Në vitin 2021, vetëm

18%

e buxhetit publik të Kosovës është shpenzuar nëpërmjet prokurimit publik.



SHTYLLA II:

BUXHETIMI DHE FINANCAT PUBLIKE

Për të matur transparencën buxhetore, KDI ka përdorur treguesit e mëposhtëm:

1. A udhëhiqen ndryshimet e buxhetit nga të njëjtat rregulla si për propozimin e buxhetit (p.sh. Publikimi I draft ndryshimeve për konsultim publik.)?
2. A janë të publikuara ndryshimet në buxhet të cilat pasqyrojnë investimet nga të hyrat vetanake komunale në ueb faqen e internetit?
3. A janë të disponueshme në faqen e internetit buxhetet e të paktën tre viteve të fundit:
 - A është buxheti i vitit 2021 i disponueshëm në faqen e internetit?
 - A është buxheti i vitit 2020 i disponueshëm në faqen e internetit?
 - A është buxheti i vitit 2019 i disponueshëm në faqen e internetit?
4. A janë të disponueshme në faqen zyrtare të internetit raportet vjetore të buxhetit për tri vitet e fundit radhazi:
 - A është raporti vjetor i buxhetit për vitin 2020 i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit?
 - A është raporti vjetor i buxhetit për vitin 2019 i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit?
 - A është raporti vjetor i buxhetit për vitin 2018 i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit?
5. A janë të publikuara raportet e shpenzimeve për vitin aktual në ueb faqen e internetit:

#	Komuna	Pikët
1	Gjakovë	11.54
1	Mitrovicë	11.54
1	Pejë	11.54
1	Prishtinë	11.54
2	Podujevë	10.96
3	Drenas	10.38
3	Ferizaj	10.38
3	Hani i Elezit	10.38
3	Kaçanik	10.38
3	Lipjan	10.38
3	Prizren	10.38
3	Rahovec	10.38
4	Fushë Kosovë	9.81
4	Junik	9.81
4	Mamushë	9.81
5	Dragash	9.23
5	Obiliq	9.23
6	Deçan	8.65
6	Kamenicë	8.65
6	Kllokot	8.65
6	Viti	8.65
6	Vushtrri	8.65
7	Gjilan	8.08
7	Istog	8.08
7	Malishevë	8.08
7	Skenderaj	8.08
8	Shtime	7.50
9	Ranillug	6.92
9	Shtërpcë	6.92
9	Suharekë	6.92
10	Klinë	6.35
11	Graçanicë	4.04
11	Novo Bërdë	4.04
12	Mitrovicë e Veriut	1.73
13	Leposaviq	1.15
13	Partesh	1.15
13	Zubin Potok	1.15
13	Zvečan	1.15

|||||

- A është publikuar raporti përmbledhës për buxhetin e komunës për vitin fiskal paraparak në ueb faqen e internetit
 - A është i publikuar raporti i tremujorit të parë të shpenzimeve për vitin aktual në ueb faqen e internetit
 - A është i publikuar raporti i tremujorit të dytë të shpenzimeve për vitin aktual në ueb faqen e internetit?
 - A është i publikuar raporti i tremujorit të tretë të shpenzimeve për vitin aktual në ueb faqen e internetit?
6. A është e publikuar korniza afatmesme buxhetore në faqen e internetit?
 7. A është e publikuar korniza afatmesme buxhetore në format të përshtatshëm për përdoruesit (word, excel, cvs, etj)
 8. A e përfshin korniza buxhetore afatmesme buxhetimin gjjinor?
 9. A është plani i investimeve i publikuar në faqen e internetit?
 10. A është raporti i auditimit në ueb faqen e internetit?

Pikët maksimale në këtë seksion janë 15 ndërsa rezultati minimal është zero. Tabela në të djathtë tregon renditjen e komunave sipas pikëve individuale në këtë shtyllë.


Rezultati mesatar për transparencë buxhetore është 69%.

Në krahasim me vitin e kaluar (2020), duke u bazuar në shtatë (7) treguesëve të produktit të njëjtë me matjet e vitit 2020, komunat kanë pasur një rritje në transparencën e buxhetit për rreth 9% (nga 64% në vitin 2020 në 73% në vitin 2021).

|||||

Grafiku në vijim tregon performancën sipas treguesve historik:

TRANSPARENCA BUXHETORE 2019-2021



SHTYLLA III:

QASJA NË DOKUMENTE DHE INFORMACIONIN PUBLIK

KDI vëzhgoi shkallën në të cilën zbatohet Ligji për Qasje në Dokumente Publike. Për të bërë këto matje, KDI ka përdorur treguesit si në vijim:

1. A ekziston ndonjë tabelë elektronike e njoftimeve në faqen zyrtare të internetit?
2. A ka ndonjë tabelë elektronike njoftimesh me arkiv që daton të paktën dy vjet më parë në faqen zyrtare të internetit?
3. A i publikon komuna pyetjet më të shpeshta të qytetarëve në faqen e internetit?
4. A iu ka përgjigjur komuna kërkesave për informata sipas ligjit për qasje në dokumente publike në formën ligjore në periudhën e caktuar në ligj?
5. A paraqitet përkatësia politike e deputetëve në ueb faqen zyrtare të komunës?
6. A jep komuna informata për pagat aktuale të deputetëve të komunës?
7. A jep komuna informata për përdorimin e vetos nga kryetari dhe të protestave të prokurorit kundër vendimeve të komunës?
8. A jep komuna informata për përdorimin e vetos nga kryetari (për vendimet e Kuvendit)?
9. A jep komuna informata për protesta të prokurorit kundër vendimeve të komunës?
10. A jep komuna informata lidhur me botimin e gazetës komunale?

#	Komuna	Pikët
1	Gjakovë	13.85
1	Mitrovicë	13.85
1	Prishtinë	13.85
2	Dragash	12.69
2	Drenas	12.69
2	Ferizaj	12.69
2	Fushë Kosovë	12.69
2	Gjilan	12.69
2	Graçanicë	12.69
2	Hani i Elezit	12.69
2	Istog	12.69
2	Junik	12.69
2	Kaçanik	12.69
2	Kamenicë	12.69
2	Klinë	12.69
2	Klllokot	12.69
2	Lipjan	12.69
2	Malishevë	12.69
2	Mamushë	12.69
2	Novo Bërdë	12.69
2	Obiliq	12.69
2	Pejë	12.69
2	Podujevë	12.69
2	Prizren	12.69
2	Rahovec	12.69
2	Ranillug	12.69
2	Shtërpcë	12.69
2	Shtime	12.69
2	Skenderaj	12.69
2	Suharekë	12.69
2	Viti	12.69
2	Vushtrri	12.69
3	Deçan	10.96
4	Partesh	9.23
5	Mitrovicë e Veriut	2.31
6	Leposaviq	1.15
6	Zubin Potok	1.15
6	Zvecan	1.15

11. A funksionon "search bar"

12. Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike

13. Numri i kërkesave të refuzuara dhe heshtja administrative (mos përgjigja)

14. Numri i kërkesave në lidhje me prokurimin publik

15. Numri i kërkesave të refuzuara në lidhje me prokurimin publik

Rezultati maksimal në këtë shtyllë është 15 ndërsa rezultati minimal është zero.

Rezultati mesatar për transparencë në politikat e qasjes në dokumente dhe informacion publik është 69%.

Dhënia e përgjithshme e përgjigjeve e komunave ndaj kërkesave për qasje në dokumente publike është në 89%. KDI ka dërguar 38 kërkesa për qasje në informata publik dhe ka marrë një përgjigje komunale nga 34 komuna; katër komuna nuk u përgjigjën.

Sipas informatave të ofruara nga komunat në përgjigje të kërkesës nga KDI, qytetarët paraqitën 745 kërkesa për qasje në dokumente publike në 34 komuna që siguruan informacionin për vitin 2021. Nga këto, 359 ishin të lidhura me prokurimin publik. Bazuar në informatat e dhëna nga komunat, nga 745 kërkesa, vetëm 13 ishin refuzuar në bazë të dispozitave juridike për mbrojtjen e të dhënave/konfidencialitetin e informacionit.

Komunat me numrin më të madh të kërkesave për qasje në dokumente publike ishin Prishtina me 87, Prizreni me 65, Suhareka me 57, Mitrovica e jugut me 53 dhe Ferizaj dhe Kaçaniku me nga 50 kërkesa për qasje në dokumente publike.

NUMRI I KËRKESAVE PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE TË DËRGUARA NGA KDI TEK KOMUNAT DHE PËRGJIGJET NDAJ TYRE

KOMUNAT	38
KËRKESAT E PARAQITURA PËR QASJE	38
KËRKESAT QË KANË MARRË PËRGJIGJE	34
KËRKESAT QË NUK KANË MARRË PËRGJIGJE	4

LISTA E KOMUNAVE QË NUK OFRUAN INFORMACIONE LIDHUR ME KËRKESAT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

1	Leposaviq
2	Mitrovicë e Veriut
3	Zubin Potok
4	Zveçan

SHTYLLA IV

PJESËMARRJA PUBLIKE

Për të matur transparencën e ofrimit të informatave për qytetarët që kanë të bëjnë me angazhimin civil dhe informimin, KDI ka përdorur treguesit e mëposhtëm:

1. A ka ndonjë instrument online që i mundëson publikut t'i paraqesë dhe t'i gjurmojë ankesat/ shqetësimet / pyetjet e tyre?
2. Sa shpesh e përdorin qytetarët ueb faqen e komunës?
3. A është i publikuar projektbuxheti për konsultime publike?
4. A janë publikuar draftet e vendimeve të kryetarit të komunës për konsultim me publikun?
5. A publikohen draftet e agjendave të kryetarit për konsultim me publikun?
6. A mund t'i dërgosh komunës letër online me pyetje?
7. Numri i dëgjimeve buxhetore nga zyra e kryetarit (min. 1 për vit)
8. Numri i dëgjimeve buxhetore nga Kuvendi Komunal (min. 1 për vit)

Pikët maksimale të caktuara në këtë shtyllë janë 15 ndërsa rezultati minimal është zero. Tabela në të djathtë tregon renditjen e komunave sipas pikëve individuale në këtë politikë të qeverisjes lokale.


Niveli mesatar i transparencës në pjesëmarrjen e publikut është 43%.

#	Komuna	Pikët
1	Mitrovicë	15.00
2	Dragash	12.00
2	Drenas	12.00
2	Lipjan	12.00
3	Gjakovë	10.50
3	Prishtinë	10.50
3	Rahovec	10.50
4	Ferizaj	9.00
4	Gjilan	9.00
4	Hani i Elezit	9.00
4	Kaçanik	9.00
5	Deçan	7.50
5	Malishevë	7.50
5	Obiliq	7.50
5	Pejë	7.50
5	Podujevë	7.50
5	Shtime	7.50
5	Skenderaj	7.50
5	Suharekë	7.50
5	Vushtrri	7.50
6	Fushë Kosovë	6.00
6	Graçanicë	6.00
6	Kamenicë	6.00
6	Mamushë	6.00
6	Shtërpçë	6.00
7	Istog	4.50
7	Klinë	4.50
7	Prizren	4.50
7	Viti	4.50
8	Junik	3.00
8	Ranillug	3.00
8	Zubin Potok	3.00
8	Zvecan	3.00
9	Klllokot	0.00
9	Leposaviq	0.00
9	Mitrovicë e Veriut	0.00
9	Novo Bërdë	0.00
9	Partesh	0.00

Treguesit me performancën më të ulët ishin:

1. "A ka ndonjë instrument online që i mundëson publikut t'i paraqesë dhe t'i gjurmojë ankesat/ shqetësimet / pyetjet e tyre?" me 16% ku vetëm gjashtë nga 38 komunat posedojnë me instrumente të tilla (Dragash, Drenas, Gjakovë, Lipjan, Mitrovicë e Jugut dhe Prishtinë).
2. "A publikohen draftet e agjendave të kryetarit për konsultim me publikun?", me 5% ku vetëm komunat e Mitrovicës së Jugut dhe Rahovecit i publikojnë ato, dhe:
3. "A është i publikuar projekt-buxheti për konsultime publike?" me 42% ku vetëm 8 komuna i publikojnë draft buxhetet për konsultim në ueb faqet e tyre, 16 komuna e publikojnë draft buxhetin përmes thirrjes për pjesëmarrje publike në dëgjimet buxhetore por jo edhe në ueb faqet e tyre, dhe 14 nga 38 komunat nuk i publikojnë fare draft buxhetet për konsultim publik.

Niveli mesatar
i transparencës
në pjesëmarrjen
e publikut është
43%



SHTYLLA V:

GRANTET DHE SUBVENZIONET

Grantet dhe financimi janë aktivitete shpesh përmes të cilave komunat shpenzojnë buxhetin e komunës.

Për të matur transparencën në grante dhe financime, KDI përdori treguesit e mëposhtëm:

1. A mundet publiku të marrë pjesë në të gjitha seancat ku diskutohet ose vendoset për ndarjen e granteve?
2. A janë të disponueshme në faqen zyrtare të internetit rregullat që rregullojnë konfliktin e mundshëm të interesit mes anëtarëve të vlerësuesve për ndarjen e granteve?
3. A janë të disponueshme në faqen e internetit të komunës kriteret specifike për dhënien e granteve?
4. A janë të disponueshme në faqen zyrtare të internetit vendimet për dhënien/refuzimin e ndarjes së grantit?
5. A ekziston në faqen zyrtare të internetit arkivi i vendimeve për dhënien / refuzimin e ndarjes së grantit për dy vitet e fundit?
6. A janë publikuar raportet e vlerësimit për dhënien e granteve në ueb faqen e internetit?
7. A ka në dispozicion në faqen e internetit të komunës informata për subvencione të ndara nga komuna?
8. Sa para i ka ndarë komuna për subvencione për këtë vit?
9. A është publikuar raporti vjetor për vitin paraprak mbi subvencione dhe dhëna në ueb faqen e internetit?
10. A janë publikuar rregulloret për dhënien e granteve në ueb faqen e internetit?

#	Komuna	Pikët
1	Ferizaj	10.00
2	Dragash	8.89
2	Gjakovë	8.89
2	Hani i Elezit	8.89
2	Kaçanik	8.89
2	Kamenicë	8.89
2	Lipjan	8.89
2	Malishevë	8.89
2	Mitrovicë	8.89
2	Obiliq	8.89
2	Pejë	8.89
2	Podujevë	8.89
2	Prishtinë	8.89
2	Prizren	8.89
2	Rahovec	8.89
2	Shtime	8.89
2	Skenderaj	8.89
2	Viti	8.89
2	Vushtrri	8.89
3	Drenas	7.78
3	Fushë Kosovë	7.78
3	Gjilan	7.78
3	Junik	7.78
4	Deçan	6.67
4	Istog	6.67
4	Klinë	6.67
4	Klllokot	6.67
4	Suharekë	6.67
5	Mamushë	4.44
6	Graçanicë	3.33
6	Novo Bërdë	3.33
6	Shtërpçë	3.33
7	Partesh	2.22
7	Ranillug	2.22
8	Leposaviq	0.00
8	Mitrovicë e Veriut	0.00
8	Zubin Potok	0.00
8	Zvecan	0.00

INDEKSI I TRANSPARENCËS PËR QEVERISJEN KOMUNALE 2021

|||||


Pikët maksimale të caktuara në këtë shtyllë janë 10 ndërsa rezultati minimal është zero. Tabela djathtas tregon renditjen e komunave në këtë shtyllë.

Niveli mesatar i transparencës në grante dhe financime është 69%.

Matja ka gjetur se nga 38 komunat, Komuna e Ferizajt është e vetmja që kishte publikuar raportet e vlerësimit për dhënien e granteve në ueb faqen e internetit.

Niveli mesatar i
transparencës në grante
dhe financime është

69%



SHTYLLA VI:

ETIKA PROFESIONALE DHE KONFLIKTI I INTERESIT

Integriteti është një nga elementët kryesorë në menaxhimin e financave publike. Sa i përket matjes së mekanizmave për të mbështetur integritetin dhe luftën kundër korrupsionit, keqmenaxhimin, konfliktin e interesit dhe abuzimin e pushtetit zyrtar, KDI përdori treguesit e mëposhtëm për të matur mekanizmat e qeverisjes së mirë në komuna.

1. A ka komuna një kod etik?
2. A është publikuar Plani i Integritetit në faqen e internetit?
3. A ka ndonjë instrument për raportimin e sjelljeve joetike, diskriminimit ose konfliktit të interesit dhe a e ka caktuar zyrtarin përgjegjës në përputhje me ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve?
4. A janë publikuar lidhjet politike ose anëtarësimet në partitë politike për anëtarët e kuvendit në faqen e internetit të komunës?

Pikët maksimale të caktuara në këtë shtyllë janë tetë, ndërsa rezultati minimal është zero. Tabela djathtas tregon renditjen e komunave në këtë shtyllë.

Niveli mesatar i transparencës në etikën profesionale dhe konfliktin e interesit është 45%.

#	Komuna	Pikët
1	Kaçanik	10.00
1	Lipjan	10.00
2	Drenas	8.00
2	Ferizaj	8.00
2	Gjakovë	8.00
2	Rahovec	8.00
2	Vushtrri	8.00
3	Deçan	6.00
3	Gjilan	6.00
3	Hani i Elezit	6.00
3	Istog	6.00
3	Junik	6.00
3	Klinë	6.00
3	Pejë	6.00
3	Podujevë	6.00
3	Prishtinë	6.00
3	Prizren	6.00
3	Shtërpçë	6.00
3	Shtime	6.00
3	Skenderaj	6.00
3	Suharekë	6.00
4	Graçanicë	4.00
4	Malishevë	4.00
4	Mitrovicë	4.00
4	Obiliq	4.00
5	Kamenicë	2.00
5	Klllokot	2.00
5	Mamushë	2.00
5	Partesh	2.00
5	Viti	2.00
6	Dragash	0.00
6	Fushë Kosovë	0.00
6	Leposaviq	0.00
6	Mitrovicë e Veriut	0.00
6	Novo Bërdë	0.00
6	Ranillug	0.00
6	Zubin Potok	0.00
6	Zvecan	0.00


Treguesit me performancën më të ulët janë:

1. "A janë të disponueshme në faqen zyrtare të komunës deklaratat e pasurisë së kryetarit?" me 13% ku vetëm pesë komuna (Ferizaj, Kaçanik, Lipjan, Prishtinë dhe Rahovec) i publikojnë deklaratat e pasurisë së kryetarit në ueb faqe e tyre, dhe
2. "A është plani i integritetit i publikuar në faqen e internetit" ku vetëm nëntë komuna i kanë të publikuara planet e përditësuar (të cilat përfshijnë periudhën e matjes) në ueb faqet e tyre.

Përderisa 24 komuna kanë instrumente specifike për raportimin e sjelljeve joetike, bazuar në informatat e pranuar nga komunat, gjatë vitit 2021 ishin 4 raste të sinjalizimit në nivel komunal.

Niveli mesatar i
transparencës në
etikën profesionale
dhe konfliktin e
interesit është

45%



SHTYLLA VII:

MENAXHIMI I PRONËS KOMUNALE DHE ANKANDET

Sa i përket matjes së mekanizmave për menaxhimin e pronës komunale, KDI përdori treguesit e mëposhtëm për të matur mekanizmat e qeverisjes së mirë në komuna.

1. A janë rregulloret për menaxhimin e pronës të disponueshme në faqen zyrtare të internetit?
2. Numri i njoftimeve për ankande në faqen e internetit të komunës
3. Numri i njoftimeve për ankande në ueb faqen e KRPP-së Pikët maksimale të caktuara në këtë shtyllë janë tetë, ndërsa rezultati minimal është zero. Tabela djathtas tregon renditjen e komunave në këtë shtyllë.

Pikët maksimale të caktuara në këtë shtyllë janë 10, ndërsa rezultati minimal është zero. Tabela djathtas tregon renditjen e komunave në këtë shtyllë.

Niveli mesatar i transparencës në menaxhimi i pronës komunale dhe ankandet është 67%.

Indeksi tregon se numri i ankandeve publike vazhdon të jetë i vogël. Artikujt e shitur përmes ankandeve nuk kanë vlerë të lartë monetare; megjithatë, publikimi i këtyre aktiviteteve në faqet e internetit të komunave është kërkesë ligjore e Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Për më tepër, procedurat për njoftimet dhe dhëniet e ankandit publik rregullohen përmes legjislacionit sekondar për prokurimin publik, dhe për këtë arsye, kërkohet edhe publikimi i tyre në faqen e internetit të KRPP-së.

Kjo kundërthënie ndërmjet dy ligjeve të sipër cekura ka bërë që 64 ankande të publikohen në ueb faqe të komunave kundrejt vetëm 10 thirrjeve të tilla në e-Prokurimi (KRPP).

#	Komuna	Pikët
1	Drenas	10.00
1	Ferizaj	10.00
1	Fushë Kosovë	10.00
1	Gjakovë	10.00
1	Gjilan	10.00
1	Junik	10.00
1	Kaçanik	10.00
1	Kamenicë	10.00
1	Lipjan	10.00
1	Mitrovicë	10.00
1	Pejë	10.00
1	Podujevë	10.00
1	Prishtinë	10.00
1	Prizren	10.00
1	Rahovec	10.00
1	Shtime	10.00
1	Skenderaj	10.00
1	Suharekë	10.00
1	Viti	10.00
1	Vushtrri	10.00
2	Deçan	5.00
2	Dragash	5.00
2	Graçanicë	5.00
2	Hani i Elezit	5.00
2	Istog	5.00
2	Klinë	5.00
2	Klllokot	5.00
2	Mamushë	5.00
2	Novo Bërdë	5.00
2	Obiliq	5.00
2	Shtërpçë	5.00
3	Leposaviq	0.00
3	Malishevë	0.00
3	Mitrovicë e Veriut	0.00
3	Partesh	0.00
3	Ranillug	0.00
3	Zubin Potok	0.00
3	Zvecan	0.00

SHTYLLA VIII:

NDËRMARRJET DHE ORGANIZATAT KOMUNALE

Ndonëse vetëm 16 komuna kanë aksione në ndërmarrje komunale apo rajonale, qytetarët e Kosovës në të gjitha qytetet ndeshen me shërbimet e ofruara nga këto kompani në baza ditore (ujësjellësi, mirëmbajtja, transporti, etj.) Ndërkohë, në komunat të cilat kanë aksione në ndërmarrje komunale, ato kanë edhe ndikim financiar duke kontribuar në arkën e komunës, apo bërë farrë financiare në rast të inkasimeve të ulëta. Për të matur transparencës në këtë politikë publike, KDI përdori treguesit e mëposhtëm:

1. A është legjislacioni bazë për organizimin, funksionimin dhe funksionet e ndërmarrjeve publike dhe institucioneve të varura i publikuar në ueb faqen e komunës?
2. A është skema organizative për përfshirjen e ndërmarrjeve publike dhe institucioneve të varura e publikuar në ueb faqen e komunës?
3. A janë të disponueshme raportet financiare vjetore të të gjitha ndërmarrjeve publike të publikuara në ueb faqe të komunës?
4. A janë faqet individuale të internetit të organizatave të ndërlidhura me komunën (organizatave buxhetore/ ndihmëse, firmave jofitimprurëse me shumicën e aksioneve të rajonit) të ndërlidhura me faqen zyrtare të komunës apo e kanë seksionin e tyre në ueb faqen e komunës?
5. Numri i kompanive me investime komunale
6. A janë të disponueshme në faqen e internetit të komunës biografitë e udhëheqësve të departamenteve, përfshirë informatat për:
 - arsimimin
 - punësimin e mëparshëm

#	Komuna	Pikët
1	Prishtinë	6.25
1	Rahovec	6.25
1	Mitrovicë	5.00
1	Pejë	5.00
1	Ferizaj	3.75
1	Dragash	2.50
1	Gjakovë	2.50
1	Gjilan	2.50
1	Hani i Elezit	2.50
1	Kaçanik	2.50
1	Kamenicë	2.50
1	Klinë	2.50
1	Malishevë	2.50
1	Podujevë	2.50
1	Prizren	2.50
1	Deçan	1.88
1	Drenas	1.88
1	Fushë Kosovë	1.88
1	Istog	1.88
1	Mamushë	1.88
2	Novo Bërdë	1.88
2	Shtime	1.88
2	Skenderaj	1.88
2	Suharekë	1.88
2	Graçanicë	1.25
2	Junik	1.25
2	Klllokot	1.25
2	Lipjan	1.25
2	Obiliq	1.25
2	Partesh	1.25
2	Ranillug	1.25
3	Shtërpçë	1.25
3	Viti	1.25
3	Vushtrri	1.25
3	Leposaviq	0.00
3	Mitrovicë e Veriut	0.00
3	Zubin Potok	0.00
3	Zvecan	0.00



7. A janë të disponueshme biografitë e bordit drejtues të ndërmarrjeve komunale publike në faqen e internetit të komunës përfshirë informatat për arsimin?

8. A ka dhënë komuna infomata lidhur me buxhetet e DKA për shkollat në juridiksioin e saj?

Indeksi tregon se transparenca komunale në ndërmarrjet dhe organizatat komunale është mjaft e ulët, me një mesatare prej vetëm 24% të tetë indikatorët e sipër cekur.

Nga 38 komuna, vetëm pesë publikojnë legjislacionin bazë për organizimin, funksionimin dhe funksionet e ndërmarrjeve publike (Ferizaj, Mitrovicë e Jugut, Pejë, Prishtinë dhe Rahovec).


Katër nga 38 komunat publikojnë skemën organizative për përfshirjen e ndërmarrjeve publike dhe institucioneve të varura (Mitrovicë e Jugut, Pejë, Prishtinë dhe Rahovec).


Përderisa vetëm Komuna e Ferizajt publikon në mënyrë të pjësshme raportet financiare të ndërmarrjeve publike, Komuna e Prishtinës është e vetmja që l ka të ndërlidhura ueb faqet individuale të ndërmarrjeve me ueb faqen e komunës, ndërsa asnjëra komunë nuk ka të publikuara biografitë e bordit drejtues të ndërmarrjeve dhe organizatave komunale publike në ueb faqen e komunës përfshirë informatat për arsimin.

Indeksi tregon se transparenca komunale në ndërmarrjet dhe organizatat komunale është mjaft e ulët, me një mesatare prej vetëm

24%

të tetë indikatorët e sipër cekur.





PËRFUNDIMET

Komunat e Kosovës kanë vazhduar të tregojnë vullnet në rritjen e transparencës në qeverisjen lokale, sidomos në politikat e prokurimit publik, buxhetit dhe financave publike, qasjes në dokumente dhe informacion publik, grante dhe subvencione si dhe në ankandet publike.

Megjithatë, indeksi shpërfaq nevojën e angazimit të qeverisjes lokale në rritjen e transparencës lidhur me ndërmarrjet dhe organizatat publike, krijimin e instrumenteve për mbrojtjen e integritetit dhe raportimin e sjelljeve jo etike, si dhe një angazhim më të madh në pjesëmarrjen publike në proceset planifikuese dhe vendimmarrëse të qeverisjes lokale.

Ndonëse në vitin 2021, indeksi ishte pasuruar me 46 tregues dhe dy politika publike të reja (duke e rritur numrin e treguesëve nga 41 tregues në gjashtë politika në 2020 në 87 tregues të shtrirë në tetë politika në 2021), 10 nga 38 komunat e Kosovës kanë arritur mbi 72 deri në 82 nga 100 pikët maksimale.

Megjithatë, mbetet shqetësues fakti se kemi katër komuna me pikë minimale nën 10 pikë, e që rrjedhimisht përveç që nuk janë llogaridhënëse ndaj qytetarëve të tyre, po ashtu ndikojnë negativ në rezultatet përmblendhëse për politika dhe rezultatin e përgjithshëm të indeksit.

Ngjashëm me gjetjet e vitit të kaluar, gjithashtu në vitin 2021 faqet e reja të internetit për të gjitha komunat nuk kanë qëndrueshmëri, dhe komunat nuk janë të qarta mbi atë se çfarë informacioni duhet t'i paraqesin publikut.

Indeksi vazhdon të ngjis shqetësime lidhur me emërtimin e dokumenteve të publikuara si dhe vendin e publikimit të tyre, kjo si rrjedhojë e mungesës së instruksioneve dhe rregullave të qarta nga niveli qendror që është administrator i ueb faqeve dhe informatave publike.

Po ashtu, indeksi ngrit shqetësime lidhur me kontaktet dhe kapacitetet komunale. 10 nga 38 komunat nuk posedojnë e-mail të komunës apo një instrument për të parashtruar një kërkesë për qasje në dokumente apo informacion publik në formë elektronike. Gjithashtu, indeksi kishte gjetur raste kur emrat e personave përgjegjës në ueb faqe nuk korrespodonte me personat përgjegjës në detyre si rrjedhojë e lëvizjeve të nepunësve apo stafit të komunës.

Gjithashtu, komunat vazhdojnë të përballen me probleme teknike ku dokumentet e ngarkuara nuk mund të hapen.





REKOMANDIMET

Prokurimi publik në nivel komunal (61% nga 100%):

- Komunitat duhet të publikojnë planin e prokurimit, publikimin e raportit vjetor të prokurimit për vitin paraprak, njoftimet për tenderë si dhe njoftimet për dhënien e kontratës.
- Përveç në rastet kur është e pamundur, rekomandojmë që komunitat të publikojnë dokumentet në format të lexueshëm (Word, Excel, Cvs, PDF machine readable)
- Për më tepër, ne rekomandojmë që të gjitha komunitat të publikojnë njoftimet e tyre të kontratave dhe njoftimet për dhënie të kontratave, kontratat e nënshkruara si dhe vendimet e OSHP-së.

Buxheti dhe financat publike (69% nga 100%):

- Ne rekomandojmë që të gjitha komunitat të publikojnë buxhetin, ndryshimet në buxhet, planin e investimeve, raportet tremujore të shpenzimeve, raportin përmbledhës për buxhetin e komunës për vitin paraprak fiskal, kornizën buxhetore afatmesme, raportin e auditimit dhe raportin vjetor për subvencionet në faqen e internetit të komunës. Publikimi i këtyre raporteve të bëhet në format të lexueshëm (Word, Excel, Cvs, PDF machine readable)

Qasja në dokumente dhe informacion publik (69% nga 100%):

- Ne rekomandojmë që të gjitha komunitat të informojnë publikun për ato që konsiderohen të dhëna dhe informacione të mbrojtura, me qëllim të

zvogëlimit të numrit të refuzimeve të kërkesave për qasje në dokumente dhe informacione publike.

- Rekomandojmë që komunitat të zhvillojnë dhe publikojnë një gazetë zyrtare komunale, përmes së cilës në mënyrë përmledhëse dhe ilustrative informojnë qytetarët për planet dhe zhvillimet komunale në afate periodike.

Pjesëmarrja publike (43% nga 100%):

- Ne rekomandojmë që komunitat të publikojnë projekt-buxhetin dhe projekt agjendat dhe vendimet e kryetarit për konsultim me publikun.
- Po ashtu rekomandojmë që të gjitha komunitat të përditësojnë informatat lidhur me personelin gjegjëse dhe të ofrojnë kontakte dhe mekanizma që ju mundësojnë qytetarëve të parashtrajnë kërkesat e tyre në formë elektronike.
- Si një praktikë e qeverisjes së mirë, me qëllim për të rritur më tej transparencën dhe llogaridhënien e zyrtarëve të zgjedhur lokalisht, ne rekomandojmë fuqimisht që, megjithëse nuk janë pjesë e këtij vlerësimi për vitin 2021, komunitat duhet të publikojnë gjithashtu raportet gjashtëmujore dhe vjetore të kryetarit, dhe planet vjetore komunale.

Grantet dhe financimi (69% nga 100%):

- Në këtë shtyllë, ne rekomandojmë që komunitat të fillojnë me publikimin e informacionit të plotë (raportet e komisioneve vlerësuese) në lidhje me



vendimet për dhënien e granteve dhe subvencioneve të mbështetura nga komunat.

**Etika profesionale dhe konflikti i interesave
(45% nga 100%):**

- Në këtë shtyllë, ne inkurajojmë komunat të ndjekin shembullin e komunave të tjera duke zhvilluar kodet etike komunale të tyre duke përfshirë krijimin r instrumenteve adekuate dhe specifike për raportimin e sjelljeve joetike.
- Ne gjithashtu rekomandojmë fuqishëm që komunat të përditësojnë planet e skaduara të integritetit dhe që të gjitha komunat t'i publikojnë publikojnë ato në ueb faqet e tyre.
- Gjithashtu rekomandojmë që komunat të publikojnë në ueb faqet e tyre deklaratat e pasurisë së kryetarëve të komunave si dhe përkatësinë politike të udhëheqjes së tyre dhe anëtarëve të kuvendeve komunale.

**Menaxhimi i pronës komunale dhe ankandet
(67% nga 100%):**

- Rekomandojmë që komunat të publikojnë rregulloret për menaxhimin e pronës të disponueshme në faqen zyrtare të internetit.

**Ndërmarrjet dhe organizatat komunale
(24% nga 100%):**

- Rekomandojmë që të gjitha komunat qytetarët e të cilave përfitojnë shërbime ng andërmarrjet publike komunale apo rajonale, që në ueb faqet e tyre të publikojnë legjislacionin që rregullon organizimin, funksionimin dhe funksionet e ndërmarrjeve publike, skemën organizative ku qytetarët mund të dhohin edhe pozitën përgjegjëse apo ndërlidhëse ndërmjet komunës dh endërmarrjes apo organizatës publike si dhe raportet vjetore financiare të ndërmarrjeve dhe organizatave publike.
- Po ashtu rekomandojmë që komunat të vendosin në ueb faqet e tyre vegëzat e ndërmarrjeve dhe organizatave publike të cilat operojnë në komunat e tyre për të leftësuar qytetarët në qasjen në informacion rreth planeve dhe aktiviteteve të këtyre ndërmarrjeve,
- Rekomandojmë që komunat të sigurojnë që ndërmarrjet apo organizatat ky ata janë aksionare të publikojnë biografite e antarëve të bordeve drejtuese, si dhe publikimin e biografisë së udhëheqësve komunal duke përfshirë informatat mbi arsimimin dhe eksperiencën paraprake të punës së tyre.

•




REKOMANDIMET PËR QEVERISJEN E NIVELIT QENDROR

- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duhet të zhvillojë Procedurat Standarde të Operimit për popullimin e faqeve të internetit të komunave, të cilat duhet të përfshijnë gjithashtu udhëzimet standarde për emërtimin e dosjeve.
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bashkëpunim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit të bëjnë përditësimin e ueb faqeve të komunave konform mundësive dhe kërkesave të teknologjisë bashkëkohore dhe standardeve për plasimin e të dhënave, duke përfshirë edhe krijimin e API për të gjitha Komunat e Kosovës.
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bashkëpunim me Komisionin Rregullativ të Prokurimit publik, të punojnë në vazhdimin dhe finalizimin e popullimit automatik të njoftimeve lidhur me prokurimet publike në ueb faqet e komunave duke u ushqyer me informata nga platforma e-Prokurimi në mënyrë automatike.
- Qeveria e Kosovës të eliminoj kundërthëniet ligjore lidhur me publikimin e thirrjeve dhe vendimeve për ankandet publike.



Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”



KDI është një Organizatë Jo-Qeveritare (OJQ) e angazhuar për të mbështetur zhvillimin e demokracisë duke përfshirë qytetarët në politikëbërjen publike dhe forcimin e sektorit të shoqërisë civile, me qëllim që të ndikojë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga institucionet publike.

Për më shumë informacion rreth KDI-së, ju lutemi vizitoni www.kdi-kosova.org

Ky projekt është financuar nga
SlovakAid – Official Development Assistance of the Slovak Republic

